



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KOPSHTIT ZOOLOGJIK
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

Drejtuar: “ARTEO 2018” sh.p.k. me NUIS: L82523203F

Adresa: Elbasan, Lagjja Luigj Gurakuqi, Bulevardi Aqif Pasha, Hotel Skampa, kati 5 nr.303.

Procedura e prokurimit/lotit: *“Procedurë e hapur e thjeshtuar, shërbime”*

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-01082-04-12-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *“Shërbim i riparimit të rrethimeve elektrike të kafshëve të egra (felinë)”*, me fond limit 4,995,116.67 (katër milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “ARTEO 2018” sh.p.k. me NUIS: L82523203F

Vlera e ofertës pa tvsh = 4,892,500 (katër milion e tetëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë.

2. Operatori ekonomik “ASI INVEST” sh.p.k. me NUIS: M01927023H

Vlera e ofertës pa tvsh = 4,753,500 (katër milion e shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë e pesëqind) lekë.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

Operatori ekonomik “ASI INVEST” sh.p.k. me NUIS: M01927023H

Për arsyet e mëposhtme:

Lidhur me pikën 2.3.1. të kriterëve të veçanta të kualifikimit: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate”, operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dëshmi për të provuar përvojën e mëparshme (sipas kërkesave të kriterit 2.3.1 të dokumenteve standarde të tenderit), të ngjashme me shërbimet e kërkuara nga AK në shtojcën 6 dhe 7 të DST. Është paraqitur fatura nr. 21/2023, datë 31.05.2023 me përshkrim “Situacion punimesh”, me vlerë 2,500,000 lekë pa TVSH për objektin “RikonstrukSION zyre dhe mobilim”. Situacioni i punimeve bashkëngjitur, nuk ka të shkruar të dhënat e faturës (numër dhe datë fature) me të cilën lidhet dhe as firmën e subjektit të cilit i është ofruar puna. Bazuar në situacionin e punimeve, asnjë nga zërat e tabelës nuk ka lidhje me zërat që kërkon të realizojë AK si dhe as objekti i përshkruar nuk lidhet fare me shërbimin e kërkuar (rrethim elektrik të kafazeve të kafshëve të egra).

Shërbimi i kërkuar është i një natyre specifike në fushën elektrike lidhur me krijimin e një rrethimi elektrik për të rritur sigurinë për kafshët me natyrë të egër siç janë luanët, tigrat dhe arinjtë, duke sjellë kështu pasiguri dhe risk serioz për implementimin e një kontratë të suksesshme. Situacioni i paraqitur nuk konstatohet të jetë një shërbim i ngjashëm, për sa i përket realizimit të këtij objekti prokurimi.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “ARTEO 2018” sh.p.k. me NUIS: L82523203F me adresë Elbasan, Lagjja Luigj Gurakuqi, Bulevardi Aqif Pasha, Hotel Skampa, kati 5 nr.303, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 4,892,500 (katër milion e tetëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë pa TVSH është identifikuar si fitues (paraprak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR